

TEMA E JAVËS

Mes SHBA-së e BE-së

Fitim Gashi

PRISHTINË, 18 - Garë mes të fortëve dhe përpjekje për t'i marrë meritat e një marrëveshjeje eventuale mes Kosovës dhe Serbisë ka prodhuar faza finale e dialogut. Derisa administrata aktuale e ShBA-së do t'i ulë palët në Washington më 27 qershor, Bashkimi Evropian nuk e ka caktuar ende datën e as agjendën. Njohës të rrëthanave shohin çakordim dhe pështjellim të Perëndimit kur vjen puna tek qasja dhe modalitetet që duhet aplikuar në dialogun Kosovë-Serbi. Sipas tyre, nëse qëllimi final i ShBA-së është kufizimi brenda marrëveshjeve ekonomike, kjo qasje do ta minonte përpjekjen e Bashkimit Evropian për një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të obligueshme.

Dialogu i Grenellit

Njohja reciproke mes Kosovës dhe Serbisë nuk do të jetë kryetemë në takimin e 27 qershorit në Washington. Gazeta ka kuptuar nga burime të ndryshme se takimi i ndërmjetësuar nga emisari i presidentit Trump për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell, do të fokusohet në çështjet ekonomike, me synimin që të arrihet një marrëveshje e tipit të "Mini-Schengenit" ballkanik. Thelbi i kësaj marrëveshjeje është lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallrave, njohja e diplomave, përkatesisht vlefshmëria e tyre për tregun të punës.

Duke iu referuar angazhimit të deri-tashëm të Grenellit, zyra e tij ka pohuar se në fokus do të jenë çështjet ekonomike.

"Qasja e ambasadorit Grenell ka qenë gjithnjë e përqendruar në zhvillim ekonomik, prosperitet dhe krijimin e vendeve të punës në Kosovë dhe Serbi. Ky do të mbetet fokusi i tij", ka thënë Dick Custin, zëdhënës i Grenellit.

Kohën kur dialogu i Bruselit ndodhej në bllokadë, me ndërmjetësimin e emisarisë amerikan u nënshkruan disa marrëveshje të vullnetit të mirë mes Kosovës dhe Serbisë, për hapjen e linjave hekurudhore dhe ajrore. Përveç zotimeve të shprehura në letër, kanë munguar veprimet e mëtejmë për jetësimin e këtyre marrëveshjeve.

Eksperti amerikan për çështjen e Ballkanit, Daniel Serwer, thotë se masat ekonomike mund të ndihmojnë në trasimin e rrugës drejt një marrëveshjeje Kosovë-Serbi, por është skeptik se kjo mund të arrihet nën udhëheqjen e Grenellit. Sipas tij, emisari amerikan deri tani vetëm ka prematur ato që tashmë dihen. Serwer po ashtu

Garë mes të fortëve dhe përpjekje për t'i marrë meritat e një marrëveshjeje evenuale mes Kosovës dhe Serbisë ka prodhuar faza finale e dialogut. Derisa administrata aktuale e ShBA-së do t'i ulë palët në Washington më 27 qershor, Bashkimi Evropian nuk e ka caktuar ende datën e as agjendën. Njohës të rrëthanave shohin çakordim dhe pështjellim të Perëndimit kur vjen puna tek qasja dhe modalitetet që duhet aplikuar në dialogun Kosovë-Serbi. Sipas tyre, nëse qëllimi final i ShBA-së është kufizimi brenda marrëveshjeve ekonomike, kjo qasje do ta minonte përpjekjen e Bashkimit Evropian për një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të obligueshme

është skeptik për një "Mini-Schengen" të mundshëm Kosovë-Serbi.

"Jam skeptik për 'Mini-Schengenin', sepse largon vëmendjen nga domosdoshmëria për t'i zbatuar marrëveshjet teknike ekzistuese midis Beogradit dhe Prishtinës", ka vlerësuar Serwer.

"Ka shumë për të bërrë në heqjen e barierave tregtare, hapjen e kontakteve të drejt-përdrejta midis dy ushtrive, inkurajimin e kontakteve ndërmjet njerëzve, zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese "teknike", sig-

urimin e mbrojtjes së pronës dhe të drejtat e domosdoshme në të dyja vendet, dhe sigurimi që shqiptarët në Serbi dhe serbët në Kosovë të kenë të drejta dhe status të krasueshëm", ka potencuar Serwer.

Kosova ka historik refuzues ndaj nismës rajonale për një "Mini-Schengen" me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, e që tani mund të shërbejë si model për raportet Kosovë-Serbi. Nisma qe kundërshtuar vazhdimisht nga udhëheqësit e Kosovës, përfshirë presidentin Thaçi, i cili pati re-



fuzuar t'u përgjigjet ftesave për ta përfaqësuar Kosovën. Sipas Thaçit, iniciativat e tillë janë të pakuptimta për aq kohë sa Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Me tone të njëjta "Mini-Schengeni" ishte kundërshtuar edhe nga partia që aktualisht udhëheq Qeverinë. Madje kryetari i Lidhjes Demokratike, Isa Mustafa, nismën e kishte quajtur përpjekje për krijimin e një "Mini-Jugosllavie" të re.

Por nisma ishte mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja, që e shohin si një fazë të ndërmjetme para integrimit të Ballokanit Perëndimor.

Analisti politik në Këshillin Gjerman për Demokratizim, Bodo Weber, thotë se kufizimi vëtëm tek zgjidhjet ekonomike nuk i kontribuojn normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Ai ka folur për mungesën e koordinimit ShBA-BE, që si pasojë mund të prodhojë një marrëveshje të dëmshme me pasojë destabilizuese për rajonin.

"Gjithçka varet se për çfarë do të negociohet në Washington: nëse kjo bëhet, përvëç interesit të dukshëm për fotografi të Grenellit në Shtëpinë e Bardhë, përkatësisht vëtëm për disa marrëveshje ekonomike, atëherë kjo qasje do ta minonte iniciativën e BE-s për rivendosjen e dialogut muajt vijues", ka potencuar Weber.

"Nëse bëhet fjalë për një marrëveshje të madhe – të tillë që mund të nënshkruhet brenda një periudhe të shkurtër dhe implikon shkëmbime territoriale - ajo nuk do të zbatohet kurrë, por vetëm sa do të shkaktojë dëme serioze, shqetësuese për stabilitetin, sigurinë, demokracinë dhe ligjshmërinë në Kosovë, Serbi, por edhe në rajon".

Nëse kjo ndodh, sipas analistik gjerman, nuk do të jetë administrata e Trumpit ajo që do të merret me pasojat në përfundim të mandatit, por BE-ja e cila do të duhej të merrej me copat e marrëveshjes.

Letra e presidentit amerikan, Donald Trump, dërguar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe atij serb, Aleksandar Vuçiq, në fund të vitit 2018, sipas njohësve, do të tentohet të jetësohet para zgjedhjeve presidenciale në SHBA. Trumpi i kishte shkruar Vuçiqit dhe Thaçit në fund të vitit 2018 duke iu thënë se do t'i mirëpresë në Shtëpinë e Bardhë në rast të arritjes së marrëveshjes.

Caktimi i takimit në Washington nga Grenelli, ditën kur emisari i BE-s për dialogun, Miroslav Lajçak, vizitoi Prishtinën, sipas analistik Weber, paraqet konflikt për primat.

"Ai (Grenell) e thirri takimin pa e informuar Lajçakun, dhe pasi me javë të tëra re-

fuzoi të bisedonte me të, të mos flasim për mundësinë e përfshirjes së dikujt nga BE-ja. Për më tepër, sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, të hënën zhvilloi një video-konferencë me shtetet anëtare të BE-së, përkatësisht ministrat e jashtëm dhe Borrellin, por i la në terr informativ sa i përket këtij takimi. Derisa ende nuk dimë rreth përbajtjes së negociatave të 27 qershorit, ne dimë për qëllimet e aktiviteteve të z. Grenell", ka shtuar Weber. Sipas tij, ky qëllim është marrja nga duart e dialogut të BE-së në kohën kur u dhanë shenja unifikimi, pa synime që të ketë shkëmbime territoriale, pa e provokuar BE-në, Berlinin dhe Parisin dhe pa e instrumentalizuar Prishtinën në funksion të këtyre ideve. Analisti gjerman thotë se administrata aktuale në ShBA po e dëshiron një triumf diplomatik para zgjedhjeve presidenciale, të cilat mbahen nënëtor të këtij viti.

"Meqë interesat personale të Grenellit dhe presidentit Thaçi duket se janë përputhur, dhe për sa i përket Trumpit e gjithë politika ka të bëjë me fushatë, jo politikë, nuk ka dyshim se performanca e zotit Grenell po ndodh duke mbajtur sytë kah zgjedhjet presidenciale", ka theksuar Weber.

Dialogu i Lajçakut

Zyrtarisht Bashkimi Evropian vazhdon të mabet i mandatuari i vëtëm nga OKB-ja sipas një rezolute të vitit 2011, për ta lehtësuar dialogun Kosovë-Serbi. BE-ja vazhdon të proklamojë unitet karshi qasjes që synon të aplikojë në lehtësimin e dialogut Kosovë-Serbi, me gjithë deklaratat kontradiktore sa u përket opsiioneve dhe kompromiseve që mund t'i bëjnë palët.

Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi në fund të vizitës në Prishtinë nuk ka treguar datën e rinisjes së negociatave në Bruksel, edhe pse ka thënë se me të i ka njoftuar palët.

"Në takimet e mia theksova se Kosova duhet të jetë e bashkuar në dialog dhe ai duhet të vendoset mbi politikën, ashtu edhe integrimi evropian që duhet vendosur mbi politikën. Dialogu duhet filluar me shpejtësi. Folëm edhe për hapa konkretë, data e prioritetë. Jam i lumtur që dialogu i lehtësuar nga BE-ja është prioritet. Pres që dialogu të rifillojë së shpejti", ka thënë Lajçak në konferencën përbillëse në Prishtinë. Ndërkëq synim final, ka shtuar ai, e ka arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të obligueshme.

"Po largohem nga Kosova me një siguri se janë krijuar kushtet për dialog", ka theksuar Lajçak.

Ai do të ketë mbështetje edhe nga shtetet kryesore të Bashkimit Evropian. Gazeta merr vesh se presidenti francez, Emmanuel Macron, është duke planifikuar të organizojë një samit në Paris më 17 korrik. Ambasada e këtij shteti në Prishtinë e ka konfirmuar për gazetën se ky samit do të mund të mbahet gjatë muajit korrik, "por tani për tani nuk ka datë të saktë të konfirmuar".

Mbajtja e një takimi të tillë si angazhim gjermano-francez kishte dështuar të mbahet më 1 korrik të vitit të kaluar, për shkak të taksës 100 për qind ndaj mallrave me



TEMA E JAVËS

originë nga Serbia. Kjo e fundit refuzonte të kthehej në tryezën e negociatave, për shkak të taksës.

Me gjithë kërkesën e Francës dhe Gjermanisë, ish-kryeministri Haradinaj pati refuzuar ta hiqte atë. Ndërkak ish-shefen e BE-së për Politikë të Jashtme, Federica Mogherini, e kishte akuzuar se bashkë me Ramën, Thaçin e Vuçiqin janë angazhuar për ndarjen e Kosovës. Tani Haradinaj iu bashkua Qeverisë, e cila nuk ka taksë ndaj Serbisë, nuk aplikon reciprocitet dhe ka hequr dorë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.

Ndërsa është paralajmëruar të nisë fazë finale e dialogut me Serbinë, ka munguar një skenim dhe vlerësim i marrëveshjeve të deritashme. Mungesa e transparencës dhe "dykuptimësia konstruktive" kanë shoqëruar procesin e deritashëm të dialogut. Nga rrëth 33 marrëveshje të arritura, vetëm disa prej tyre janë zbatuar plotësisht. Është Marrëveshja reciproke për njohjen e policave të sigurimit të automjeteve, Marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore, si dhe Marrëveshja për njohjen reciproke të certifikatave ADR, Marrëveshja për telekomunikime.

Por zbatimi i plotë i marrëveshjes për Urën Ibrit ende nuk ka filluar, megjithëse janë finalizuar punimet rrëth rivitalizimit të saj, të cilat kishte marrë përsipër t'i kryente Bashkimi Evropian. Problem ka dalë edhe përcaktimi i kufirit administrativ mes Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe asaj të Veriut, që është pjesë e pakos së marrëveshjes për lëvizjen e lirë.

Edhe pse me Ligjin për kufijtë administrativë Suhodollit i përshkruhet Mitrovicës Jugore, udhëheqja komunale e Veriut pretendon se kjo lagje duhet t'u takojë atyre. Asnjë përparrim nuk është shënuar as në zbatimin e Marrëveshjes për energji. Kompania me originë nga Serbia deri tani ka refuzuar të regjistrohet në Kosovë në pajtim me ligjet e vendit, ashtu siç e përcakton marrëveshja.

Dykuptimësia konstruktive është elementi që ka shoqëruar dialogun e Brukselit, ku palët i interpretionin marrëveshjet sipas versionit të tyre. Ndërkak BE-ja në rolin e ndërmjetësuesit të këtij procesi vetëm ka njoftuar përtakimet e mbajtura, përmes komunikatave për media, por nuk i ka interpretuar marrëveshjet. Kjo ka prodhuar paqartësi dhe mungesë transparence. Nuk ka pasur raportime të rregullta në Kuvendin e Kosovës për marrëveshjet, përvèç në rastet e pyetjeve parlamentare, raportimet në komisione apo interpelanca.

Mungesa e unitetit

Vizita e Lajçakut nuk e bashkoi spektrin politik. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka kërkuar që dialogu mes Kosovës dhe Serbisë të zhvillohet me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sa i përket udhëheqjes së dialogut në emër të Kosovës, sipas tij, këtë nuk mund ta bëjnë ata që kanë kontrabanduar pushtetin. Kjo parti nuk i është përgjigjur as ftesës së kryeministrit Hoti për t'i koordinuar veprimet para takimit në Shtëpinë e Bardhë.



Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčak, në fund të vizitës në Prishtinë nuk ka treguar datën e rinisjes së negociatave në Bruksel, edhe pse ka thënë se me të i ka njoftuar palët

Por zhvendosjen e dialogut në Washington e kanë mirëpritur të gjitha subjektet e tjera, përfshirë PDK-në, që është në opozitë.

Nënkyetari i kësaj partie, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosova është një temë perëndimore, ku angazhimin e SHBA-së dhe të BE-së e shohin si pjesë të një procesi të njëjtë.

"Uniteti transatlantik çdoherë ka prodhuar marrëveshje historike dhe të dobishme për Kosovën. Është në interesin e Kosovës që kjo të ndodhë, që BE-ja dhe SHBA-ja të kenë qëndrime të njëjtë për qëllimet, parimet dhe pritet në dialog. Kjo është natyrisht e rëndësishme për vetë amerikanët dhe evropianët", ka thënë Hoxhaj. Ai ka shtuar se takimi në Washington është një shans historik që duhet shfrytëzuar menjëng nga ana e Kosovës. Po ashtu, një takim në Paris, sipas Hoxhajt, duhet t'u shërbejë pritet e njëjtë.

"Gjasat janë të mëdha për një marrëveshje nëse ka unitet të brendshëm dhe unitet perëndimor, me agjendë kohore dhe përbajtjesore. Vijat e kuqe janë të dhëna qartë për shumë kohë dhe të gjitha janë në Kushtetutën tonë. Por që mendoj se duhet të ndodhe është përgatitja tematike dhe këtu nuk ka shumë hapësirë se koha është e shkurtër", ka potencuar ish-zëvendëskryeministri Hoxhaj.

Kosova i kontribuoi ndarjes BE-ShBA

Presidenti Thaçi, edhe pse u zmbrraps nga refuzimi që ta takojë emisarin e BE-së, në disa raste ka përsëritur se BE-ja nuk ka kredibilitet për t'i ndërmjetësuar palët, përderisa nuk ia heq vizat Kosovës.

Donika Emini nga platforma "Civikos" ka thënë se qasja refuzuese e presidentit ndaj negociatorëve evropianë e ka dëmtuar procesin dhe i ka fryrë ndarjes ShBA-BE. Sipas

saj, Kosova nuk e ka luksin e as fuqinë t'i refuzojë ndërmjetësit e BE-së.

"Nuk po e kuptoj sjelljen e presidentit Thaçi, kur ai vetë ka qenë krah për krah me zonjën Mogherini derisa ajo pranonte një marrëveshje që u shkonte për shtati Vuçiqit dhe Thaçit. Një qasje të tillë po e aplikon edhe Vuçiqi në Serbi, duke tentuar që të imponojnë negociatorë që u shkojnë përshtati", ka theksuar Emini.

Presidenti Hashim Thaçi ka marrë primatin në negociata para më shumë se dy vjetësh, duke zhvilluar disa takime me homologun e tij serb, Aleksandar Vuçiq. Por, e kanë mohuar se ekziston ndonjë draft-marrëveshje, ashtu siç pretendonte ish-kryeministri në detyrë, Kurti. Një nga arsyet e rrëzimit të qeverisë Kurti ishte pikërisht heqja e pengesave në dialog, ku LDK-ja doli kundër vendosjes së reciprocitetit me Serbinë, masë kjo e cila u kundërshtua edhe nga emisari i presidentit amerikan.

Hoti jo vetëm që e hoqi reciprocitetin, por përbushi edhe një kusht tjetër të Serbisë, që ajo ta ndalë fushatën kundër shtetësisë së Kosovës. Për aq kohë sa tentohet të arrihet marrëveshja në Washington, Kosova nuk do të kërkojë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare.

Nënshkrimi i marrëveshjes finale Kosovë-Serbi në "Kopshtin e trëndafilave" në Washington, duke iu bashkëngjitur presidentit Thaçi, është misioni kryesor që i përshkruhet Qeverisë së re dhe kryeministrin Avdullah Hoti, i cili nuk ka një bazë të fuqishme me numra në Kuvend.

Hoti ka insistuar se dialogun do ta udhëheqë Qeveria dhe se nuk do të lejojnë ndryshimin e kufijve të 17 shkurtit të vitit 2008. Por në programin qeverisës presidentit ia përshkruan rolin përfaqësues në këtë proces. Sipas një aktgjykimi të Gjykatës



Foto: Alban Bujari

Takimi i ndërmjetësuar nga emisari i presidentit Trump për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell, sipas burimeve të Kohës, do të fokusohet në çështjet ekonomike, me synimin që të arrihet një marrëveshje e tipit të "Mini-Schengenit" ballkanik

Kushtetuese të vitit të kaluar, dialogun duhet ta udhëheqë Qeveria. Aktgjyki i kishte rrëzuar delegacionin shtetëror të krijuar nga ish-kryeministri Haradinaj dhe qartazi përcaktoi rolin e kryeministrit në dialog. Sipas aktgjykimit, kryeministri duhet të jetë udhëheqës i këtij procesi, por që këshillohet me presidentin dhe mbikëqyret nga Kuvendi i Kosovës.

“Gjykata konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar ta mbikëqyrë politikën e jashtme në kuadër të kompetencave kushtetuese të parapara sipas paragrafit 12, të nenit 65, të Kushtetutës”, thuhet në aktgjykimin e publikuar më 27 qershori 2019.

“Gjykata po ashtu thekson se paragafi 1, i nenit 93 të Kushtetutës, i përcakton kompetencat e Qeverisë në “propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit”, si dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94, përcaktojnë se kryeministri, si i pari i Qeverisë, “përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë”, si dhe “këshillohet me presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit”.

Ambicjet e Serbisë për ndarje

Me gjithë deklaratat optimiste të presidentit Thaci dhe kryeministrit Hoti se në Washington po shkojnë për njohje reciproke me Serbinë, për këtë të fundit kjo çështje as që vjen në konsideratë. Njëjtë sikurse emisari Grenell, edhe presidenti Vuçiç ka deklaruar se në Shtëpinë e Bardhë do të flasin për ekonomi dhe tregti. Politikë zyrtare e Beogradit është përcaktimi i kufirit, ide të cilën e kanë shpalosur në disa raste zyrtarët e lartë serbë. Veriu i Kosovës, që popullohet me shumicë serbe, vazhdon t'i ruajë lidhjet me Serbinë, megjithëse

Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshjen e 19 prillit për integrimin e kësaj pjesë brenda juridiksionit vendor. Megjithatë, katër komuna atje vazhdojnë të përmenden në kontekst të pazarit që mund të bëhet me Serbinë. Beogradit zyrtar ka shfaqur synimin që këtë pjesë t'ia shkëpusë Kosovës. Madje shefi i diplomacisë serbe, Ivica Daçiç, në disa raste ka përmendur ndryshimin e qëndrimit amerikan në raport me çështjen e Kosovës. Sipas tij, në administratën e Trumpit për herë të parë është shtruar pyetja se çfarë pret Serbia nga marrëvesha finale, “përdallim prej atyre të mëparshme që thoshin se pavarësia e Kosovës është e panegociueshme”.

Për ndryshim kufijsh ka folur edhe presidenti Thaci, që e ka transformuar disa herë idenë e “korrigimit” në shkëmbim territoresh. Mesazhin e pati dhënë, teksha ka përmendur “dhuratën” e Aleksandar Rankoviçit. Rankoviç ka qenë një prej autoriteteve kryesore të Jugosllavisë gjatë viteve '50, '60 dhe '70 të shekullit të shkuar. Me qëllimin për ta rritur përqindjen e serbëve në Kosovë, disa territorë që u takojnë komunave në veri, Leposaviq e Zubin-Potok, ia kishte bashkëngjitur Kosovës.

Thaci i premtoi edhe Luginës së Prezhevës, Medvegjës dhe Bujanocit se do ta institucionalizojë plebishitin e vitit 1992, përbashkëngjitur me Kosovën. Përfaqësuesit shqiptarë atje vazhdimisht kanë kërkuar reciprocitet me veriun e Kosovës. Por në tetë vjetët e dialogut, që kryesisht është udhëhequr nga Thaci, kërkuesat e tyre nuk janë shqyrtuar asnjëherë. Të dështuara kanë rezultuar edhe përpjekjet e mëhershme të Luginës që të imponohen në dialogun Kosovë-Serbi.

Themelimi i Asociacionit është kërkuesë e përhershme e serbëve, të cilin duan ta

veshin me kompetenca ekzekutive. Kryeministri Hoti është zotuar se do t'i rikthehet zbatimit të marrëveshjes për themelin e këtij mekanizmi, gjë të cilën e ka rekomanuar edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, aty ku Hoti e ka shpalosur kornizën dialoguese për fazën e ardhshme të negociatave me Serbinë.

Ne qeverinë e fundit të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, Asociacioni nuk ka qenë pjesë e programit.

Asociacioni është obligim që del edhe nga Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Kosovës dhe BE-së, i cili megjithatë ishte miratuar nga qeveria Kurti. Përparimi i Kosovës në rrugën drejt integrimit varet nga shkalla e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të Brukselit.

Më 23 dhjetor të vitit 2015, Kushtetuesja pati konstituar shkelje në të shtatë kapitujt e Marrëveshjes së Parimeve për Asociacionin/Bashkësinë, e nënshkruar në gusht të vitit 2015. Sipas Kushtetueses, objektivat e Asociacionit, të definiuara në aktin juridik dhe në Statut, duhet të garantojnë standarde kushtetuese për vetëqeverisje lokale. Gjykata ka gjetur se Asociacioni nuk mund të vishet me autoritet të plotë dhe ekskluziv për të promovuar interesat e komunitetit serb të Kosovës në marrëdhëni me autoritetet qendrore. Serbia ka pretendime t'i fusë nën autoritetin e Asociacionit edhe dy resurset kryesore të Kosovës - Liqenin e Gazivodës dhe “Trepçën”.

Përzierja e Rusisë

Pas paralajmërimeve për rinisjen e dialogut Kosovë-Serbi është aktivizuar edhe Rusia, duke rikujtuar se pa mbështetjen e tyre një marrëveshje eventuale nuk do të mund të miratohej në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Përfshirjen e Moskës e kanë mirëpritur në Serbi dhe zyrtarë të Administratës Trump, të cilët merren me dialogun Kosovë-Serbi.

Por, sipas analistikëve Serber, Rusia nuk do të përfshihet pa një interes të madh.

“Këshilli i Sigurimit do të duhej ta aprovonte anëtarësimin e Kosovës në Komitet e Bashkuara pa veto nga Rusia apo Kina. Por Putini do të kërkojë një çimim të lartë për këtë: njohja e mundshme nga SHBA-ja e “pavarësisë” së Abkazisë dhe Osetisë së Jugut, si dhe aneksimi rus i Krimës”, ka theksuar Server.

Përveç njohjes reciproke me Serbinë, synim final i Kosovës është edhe ulësja në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Opioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në vitin 2010 përkitazi me ligjshmërinë e shpalljes së Pavarësisë ishte cilësuar një fitore e madhe për Kosovën, por nuk i kishte ndihmuar vendit ta merrte ulësen. Me gjithë premtimet e qeverive të deritashme, Kosova nuk arriti të anëtarësohej as në Këshillin e Evropës, Interpol, UNESCO. Edhe pas opinionit të GJND-së, Kosova pranoi që në forume të ndryshme rajonale të prezantohet me fusnotë, sipas së cilës në Kosovë vlen ende Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, krahas opinionit të GJND-së.